

PROCES VERBAL

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **OBJEKTI I PROCEDURËS: “FV KAMERA SIGURIE NE HAPESIRAT PUBLIKE TE QYTETIT, RRUGET DHE KRYQEZIMET KRYESORE”**
- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):;**
35125300-2 - Kamera sigurie
- **VLERA E FONDIT LIMIT:**
- Sigurimi i ofertës 2% e fondit limit sipas nenit 30, pika 3, te VKM nr.285, datë 19.05.2021 ne vleren :
Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Bashkia BERAT** ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se vlera e fondit limit të prokuruar.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se:

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të

kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës; ne pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara me poshtë, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ne pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Duke qenë se kjo procedure prokurimi bazuar në vlerën e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe

nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe demonstron se Operatori Ekonomik ka aftësi financiare për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të kërkuar cilësor. Gjithashtu ky kriter është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

2.3. Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme të realizuar me një ent publik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga entit publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shenohen, vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shenohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin parashikohet se:

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me pikën 4 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilën është e përcaktuar se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te disponoje Autorizim të prodhuesit/ve ose Distributorit te autorizuar prej prodhuesit për furnizimin e listës se artikujve si me poshte :

- NVR 64 KANALE
- KAMERA E JASHTME ME NGJYRA 24 ORE IP
- KAMERA PER LEXIMIN AUTOMATIK TE TARGAVE
- KAMERA E JASHTME PTZ
- SWITCH 5 PORTA
- SWITCH 24 PORTA
- VIDEO WALL PROCESOR
- MONITOR PROFESIONAL VIDEO WALL
- SOFTWARE PER MENAXHIMIN E KAMERAVE TE SIGURISE

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij kurse ne rastin e Autorizimit nga Distributori i Autorizuar do te paraqitet dhe akt-marreveshja/akti perkates.

Argumentim:Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6,8 të nenit 40, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike

2.3.3 Per te vertetuar perputhshmerine me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skedat teknike (datasheet) nga prodhuesi i mallrave që oferton per produktet si më poshtë:

- NVR 64 KANALE
- KAMERA E JASHTME ME NGJYRA 24 ORE IP
- KAMERA PER LEXIMIN AUTOMATIK TE TARGAVE
- KAMERA E JASHTME PTZ
- SWITCH 5 PORTA
- SWITCH 24 PORTA
- VIDEO WALL PROCESOR
- MONITOR PROFESIONAL VIDEO WALL
- SOFTWARE PER MENAXHIMIN E KAMERAVE TE SIGURISE

Argumentim : Ky kriter është në përputhje me nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të nenit 40, pika 6 b, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Paraqitja e katalogëve apo skedave teknike për artikullin që është objekt prokurimi, është kërkuar me qellim verifikimin e përputhshmërisë të artikujve që operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike të percaktuara.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka minimalisht per periudhen muajin e fundit 8 (tete) punonjës të profilizuar si më poshtë:

- 1 (nje) inxhinier elektronik të certifikuar nga prodhuesi i sistemeve te kamerave që do të ofroj, per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomen perkatese ose vertetim diplome dhe certifikatën e trajnimit nga prodhuesi i sistemit të kamerave dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar;
- 1 (nje) inxhinier elektrik , per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomen perkatese ose vertetim diplome dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar;
- 1 (nje) specialist TIK , per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomen perkatese ose vertetim diplome dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar;

- Minimumi 5 (pese) punonjës të siguruar si montues të pajisjeve elektronike ose teknik elektronik ose profesione ekuivalente të certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve të kamerave, kjo të vërtetuar me listpagesat e muajit të fundit dhe certifikatave të trajnimit nga prodhuesi

Për stafin e sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomati/ Vertetim diplomimi sipas ligjit/Certifikatat përkatëse të kursit apo trajnimit
- Duhet të figurojnë në listepagesat e kompanisë E-Sig për muajin e fundit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me Nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në Rekomandimin e APP Nr. 8197, datë 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit mallra, pune, shërbime”.

Për shkak se kemi të bëjmë me një procedurë furnizim-vendosje, ky kriter gjen mbështetje edhe në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pikën 4, ku përcaktohet se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose,

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj.

Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose,

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

, ç)mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar kriterit të mesiperm për realizimin me sukses dhe brenda afateve është kërkuar prezenca në stafin e operatorit ekonomik e një numri minimal prej 8 të punësuarisht duke marrë në konsideratë nevojën për inxhinierë të specializuar për drejtimin e proceseve komplekse (sic shpjegohet me poshte) që përfshijnë rrjetin e fibrës optike, punimet për instalimin (f.v) të kamerave, integrimin e të gjithë rrjetit në një sallë të vetme monitorimi të qëndërzuar etj dhe nevojën për të realizuar e sukses të gjithë kontratën brenda një afati 2-mujor.

Për të garantuar eksperiencën e stafit të operatorit ekonomik pasi kemi të bëjmë me një procedurë që për nga vlera dhe kompleksiteti janë shumë të rëndësishme është kërkuar prezenca në stafin e operatorit ekonomik për të paktën muajin

Konkretisht janë kërkuar

- 1 (nje) inxhinier elektronik të certifikuar nga prodhuesi i sistemeve të kamerave që do të ofroj – Ky kriter është i nevojshëm pasi inxhinieri elektronik është personi që do të angazhohet drejtpërdrejtë në mbikqyrjen e proceseve të instalimit të rrjetit të fibrës optike dhe kamerave të cilat janë pajisje elektronike dhe gjithashtu do të asistojë AK në rast defektesh gjatë periudhës së garancisë.
Gjithashtu është e nevojshme të jetë i trajnuar/certifikuar nga prodhuesi i kamerave që do të ofroj pasi ky person do të jetë përgjegjës për realizimin e konfigurimeve sipas funksionaliteteve të kërkuara në Termat e Referencës (p.sh leximi i targave, identifikimi i lëvizjeve, dalja nga kufiri i vendosur etj).
- 1 (nje) inxhinier elektrik , për të cilin O.E duhet të paraqesi diplomën perkatese – Ky kriter është i nevojshëm pasi inxhinieri elektrik është personi i cili do të mbikqyrë dhe drejtojë të gjithë proceset dhe lidhjet e nevojshme me rrjetin e energjisë elektrike dhe do të garantojë zbatimin e rregullave teknike sipas ligjit Nr. 8734 datë 01.02.2001 “ Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, indryshuar.
- 1 (nje) specialist TIK , për të cilin O.E duhet të paraqesi diplomën perkatese ose vertetimi diplome dhe të figuroj në listpagesa për periudhën e kërkuar- Ky kriter është i nevojshëm pasi Specialisti Tik do të jetë personi përgjegjës për integrimin e të gjithë sistemit në një platformë të vetme, transmetimin e të dhënave në Videowall dhe ruajtjen e tyre në server.

- Minimumi 5 (pese) punonjës të siguar si montues të pajisjeve elektronike ose teknik elektronik ose profesione ekuivalente të certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve të kamerave- Referuar VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 “PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR , montuesit/teknikët do të jenë personat e drejtpërdrejtë që do të angazhohen në kryejren e punimeve për furnizim-vendosjen e rrjetit të fibrës optike, instalimet e kamerave në pikat e caktuara nga AK etj. Trajnimi/Certifikimi nga prodhuesi është garanci për AK se këta persona janë të aftë dhe kanë eksperiencën e nevojshme për të realizuar instalimin e pajisjeve brenda afatit të realizimit të kontratës pasi kanë marrë të gjithë njohuritë e nevojshme për produktet që do të montojnë.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet ketë dhe të paraqesë certifikatat e konformitetit me Standartet ISO si mëposhte:

- a. Certifikate: EN- ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilësisë;
- b. Certifikate: ISO/IEC 20000-1 – Per teknologjine e Informacionit-Menaxhimi iShërbimit ;
- c. Certifikate: ISO 39001 - Per sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor ;

Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizëm kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat ISO duhet të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë. Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili operator ekonomik duhet të disponojë certifikatat ISO sipas zërave/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përmbushja e standarteve ISO është thelbësore, dhe i siguron AK se operatori ekonomik fitues është serioz dhe ka kaluar procese vlerësimi në lidhje me respektimin e standarteve të mesiperme të cilat kanë lidhje me objektin e prokurimit.

Konkretisht:

Certifikate: EN- ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilësisë - Përmbushja e standardit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së mallrave që parashikon kontrata. Nisur nga proceset e punes dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punes se tij, t'i bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara. Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë të kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

Certifikate: ISO/IEC 20000-1 – Per teknologjine e Informacionit-Menaxhimi i Shërbimit ; ISO 20000-1 është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës. Standardi përshkruan një seri procesesh menaxhimi të krijuara për të ndihmuar kompanitë të ofrojnë shërbime më efektive të IT (si për ato brenda kompanisë ashtu edhe për klientët e tyre).

Certifikate: ISO 39001 - Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor ;- ISO 39001 tregon përmbushjen e standardeve më të mira në menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor dhe duke qenë se pjesa më e madhe e punimeve për shtrirjen e rrjetit të fibrës optike por dhe instalimi i kamerave do të kryhet në rrugët dhe kryqëzimet kryesore në qytet, është një garanci për Ak se operatori ekonomik ka kaluar një proces vlerësimi sa i përket respektimit të këtyre standardeve nga organizma serioz.

2.3.6 Per shkak se kjo është një procedurë Furnizim-Vendosje malli dhe do të ketë nevojë për kryerjen e punëve për instalimin e produkteve, Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me License Profesionale të leshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë të kategorisë :

NS 13 A- Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5, gërma a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo licencë është e lidhur me natyrën dhe llojin e procedurës së prokurimit e cila është F.V pra do të kryhen punime për vendosjen dhe instalimin e mallrave dhe tregojnë profesionalizmin dhe aftësinë tekniko-profesionale të operatorëve ekonomik për të kryer instalimet e nevojshme.

Në pikën 18 të nenit 4 të LPP parashikohet se:

18. “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave.

Një kontratë publike furnizimi mund të përfshijë në mënyrë **dytësore edhe vendosjen edhe instalimin.**

Kërkesa për kategorinë NS bazohet në **VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI”** e ndryshuar **ku parashikohet se:**

N.S - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Në kuadër të realizimit me sukses të kontratës do të shtrihen rreth 18.000 m fibër optike prandaj kjo kërkesë është në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të disponojë **2 (dy) automjete** për realizimin e instalimeve, për të cilët duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Lejen e qarkullimit
- Policen e sigurimit
- Çertifikaten e kontrollit teknik
- Taksat vjetore

Ne rast se mjetet e lartpërmendura janë marre me qera ofertuesi duhet të paraqesë **Kontratën e marrjes me qira të mjetit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka

pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër

Argumentimi: Ky kriter, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa e mesiperme i sherben AK si garanci se operatori ekonomik fitues ka mjetet e nevojshme për të realizuar me sukses implementimin e kontratës brenda afateve.

Duke marrë në konsideratë se për realizimin me sukses të kësaj procedure do të shtrihen rreth 18.000 m fibër optike në qytet dhe do të montohen kamerat dhe monitoret, 2 automjete është numri minimal i nevojshëm që dëshmon aftësinë e operatorit ekonomik për të bërë transportin e materialeve në pikat e montimit për të paktën 2 grupe pune cdo ditë.

2.3.8 Operatori ekonomik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë mostra të produkteve sipas listës së mëposhtme:

- KAMERA E JASHTME ME NGJYRA 24 ORE IP (1 cope)
- KAMERA PER LEXIMIN AUTOMATIK TE TARGAVE (1 cope)
- KAMERA E JASHTME PTZ (1 cope)
- SWITCH 5 PORTA (1 cope)
- VIDEO WALL PROCESOR(1 cope)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur nga grupi i pune i krijuar për hartimin e e projektit ,preventivit, afatit të punimeve dhe relacionin teknik , në përputhje me nenin 4,pika 7, 38, nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 40, pika 2, të V.K.M-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur D.S.T-ve në S.P.E.

